



Nr. 04/23

Datë: 14.06.2023

Prishtinë

Në mbështetje të nenit 9 pika 2 dhe të nenit 106 pika 1 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame (në tekstin e mëtejme FSI), në mbështetje të vendimit nr. 47/22 të Këshillit Mësimor Shkencor të FSI-së, si dhe në mbështetje të vendimit nr. 34/23 të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, FSI miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është që të garantoj një vendimmarrje të paanshme dhe transparente, në interes të institucionit nga të gjithë zyrtarët e Fakultetit.

Neni 2

Objekti

Objekt i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave, mjeteve dhe procedurave për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe zgjidhjen e rasteve të tilla.

Neni 3

Përkufizime

- a. **“Interes i institucionit”** është interes pasuror ose jo-pasuror në dobi të institucionit.
- b. **“Interes privat”** është çdo interes pasuror ose jo-pasuror në dobi të drejtpërdrejtë të zyrtarit ose familjarit të tij, të afërmit ose personave me të cilët ai ka pasur ose ka marrëdhënie ekonomike.

- c. **“Zyrtar”** është çdo person që është i angazhuar dhe që kryen detyra të ndryshme në cilësinë e stafit akademik, administrativ apo edhe teknik.
- d. **“Mbikëqyrës i një zyrtari”** është çdo person apo organ kolegjal i cili ka kompetenca vendimmarrëse, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese të drejtpërdrejta mbi zyrtarin.
- e. **“Person i lidhur”** është çdo person i cili ka lidhje interesi, pasurore ose jo pasurore me zyrtarin, bashkëshortin, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime dhe të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt.
- f. **“Konflikt interesi”** është gjendje e konfliktit ndërmjet detyrave dhe përgjegjësive dhe interesave të drejtpërdrejta ose të tërthorta të zyrtarit, që ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij.

Neni 4

Veprimet e ndaluara

Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit, përveç veprimeve të ndaluara të parapara me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, të ndaluara janë edhe këto veprime:

- a) Profesorit i ndalohet të vlerësojë studentin i cili është në lidhje familjare në vijë të drejtë deri në shkallën e katërt.
- b) Mbikëqyrësit i ndalohet të vlerësojë performancën e zyrtarit i cili është në lidhje familjare me të siç përcaktohet të pika (e) të përkufizimet.
- c) Zyrtarit i ndalohet të marr pjesë në grupe punuese apo organe kolegjiale prej të cilave mund të rezultojë konflikt i hapur interesi.
- d) Zyrtarit i ndalohet të përdorë informacionin zyrtar për qëllime të përfitimit personal.
- e) Zyrtarit që ka pozitë menaxhuese, dhe i cili angazhohet në punë tjera, duhet të kujdeset të mos dëmtojë reputacionin e institucionit ose ta sjellë vetën në gjendjen e konfliktit të interesit.
- f) Zyrtarit që ka pozitë menaxhuese i ndalohet të propozoj vetën ose anëtarin e ngushtë të familjes si përfitues të ndonjë të drejte pasurore ose jo pasurore.

Neni 5

Interesat private

Interesat e zyrtarëve që mund të ndikojnë lindjen e konfliktit të interesit janë:

- a) Të drejta dhe detyrime pasurore;
- b) Dhurata, premtime, favore ose trajtime preferenciale;
- c) Premtme të mundshme për punësim në të ardhmen ose negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin;
- d) Marrëdhënie familjare apo të miqësisë së mirë me zyrtarin;
- e) Angazhimi i mëparshëm nga i cili kanë buruar ose ende burojnë interesa pasurore ose jo pasurore për zyrtarin.

Neni 6

Vlerësimi për çdo rast i konfliktit të interesit

- a) Çdo zyrtarë në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij, duhet të bëjë vlerësimin paraprak, rast për rast të ekzistimit të interesit të tij privat, që mund të ndikojnë në lindjen e një konflikti interesi.
- b) Nëse zyrtari vlerëson se në rastin konkret mund të ketë konflikt interesi, atëherë vetë-përrjashtohet nga vendimmarrja në rastin konkret dhe lajmëron me shkrim mbikëqyrësin.
- c) Nëse mbikëqyrësi vlerëson se zyrtari i tij në rastin konkret mund të përfshihet në konflikt interesi nëse merr pjesë në vendimmarrje, atëherë atë e përjashton nga rasti konkret duke e larguar nga vendimmarrja dhe duke e njoftuar me shkrim për arsyen e largimit.
- d) Çdo zyrtar që merr pjesë në një grup pune ose organ kolegjal, është i detyruar që të deklarojë nëse ka konflikt interesi në atë grup dhe të vetë-përrjashtohet ose të përjashtohet për rastin konkret.

Neni 7

Identifikimi i interesit privat nga personat e tretë

- a) Nëse një person i tretë ka informacion për interesin privat të zyrtarit dhe i cili mund të ndikojë në krijimin e situatës së konfliktit të interesit, atëherë ai me shkrim njofton mbikëqyrësin e zyrtarit.
- b) Çdo palë e interesuar që nuk është e përfshirë në vendimmarrje dhe e cila ka informacione për interesin privat të zyrtarit, llogaritet si person i tretë dhe mund të jetë burim i informacionit për mbikëqyrësin.

Neni 8

Zgjidhja e konfliktit të interesit

- a) Nëse paraqitet konflikti i interesit në rastin konkret, atëherë personi përgjegjës për zgjidhjen e tij është mbikëqyrësi i zyrtarit.
- b) Nëse paraqitet konflikti i interesit në nivel të dekanit, atëherë personi përgjegjës për zgjidhjen e tij është (KMSH).
- c) Instanca e fundit e zgjidhjes së konfliktit të interesit është KMSH.

Neni 9

Masat disiplinore

- a) Nëse një zyrtar përfshihet në konflikt të hapur interesi, është bazë për iniciimin e procedurës disiplinore.
- b) Në rastin kur në konflikt interesi përfshihet stafi akademik, atëherë rasti i paraqitet Komisionit të Etikës.
- c) Në rastin kur në konflikt interesi përfshihet stafi tjetër, atëherë rasti i paraqitet komisionit disiplinor në nivelin institucional.
- d) Vendimet e marra në konflikt të hapur interesi, nga mbikëqyrësi mund të anulohen nëse dëmi që shkaktohet me anulimin e vendimit është më i vogël se dëmi që është shkaktuar me vendimin e nxjerrë në rrethana të konfliktit të interesit.

Neni 10

Dispozitat përfundimtare

- e) Dispozitat e kësaj rregullore janë plotësim i dispozitave të Kodit të Etikës dhe nuk shfuqizojnë apo ndryshojnë asnjë dispozitë të tij.
- f) Zbatimi i kësaj rregullore bëhet në frymën e parimeve të përcaktuara në Kodin e Etikës për secilin rast veç e veç.
- g) Në asnjë rast, dispozitat e kësaj rregullore nuk mund të zbatohen apo interpretohen në drejtim të kufizimit të lirisë akademike.
- h) Secili rast i konfliktit të interesit konsiderohet rast unik dhe nuk lejohet përdorimi i rasteve të mëparshme si praktikë për vendosje.
- i) Kjo rregullore aplikohet për stafin akademik dhe administrativ pa përjashtim, vetëm pas aprovimit nga KMSH dhe BIRK.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më datën e miratimit të saj nga KMSH dhe aprovimi nga Kryesia BIRK-ut.

Prishtinë,
14.06.2023

DEKANI



Prof. asoc. dr. Islam Hasani